



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 80/14 prot.

Pogradec, më 26.02.2026

VENDIM

NR. 22, DATË 25.02.2026

PËR

“ NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 130, DATË 22.12.2025 MBI MIRATIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 5, ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, të forcave të armatosura, të shërbimit informativ shtetëror dhe të policisë së burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, të ndryshuar, me propozim të kryetarit të bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit në pikën 3 të Vendimit 130, datë 22.12.2025 mbi listën e nxënësve, banues në Pogradec, që përfitojnë bursë për vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional në qytete të tjera për vitin shkollor 2025-2026.



Handwritten signature

1.1. Trajtimin me bursë të plotë për nxënësin Arsenio Ferdinand Xhelo, në klasën e XI në shkollën e mesme profesionale "Charles Telford Erickson" Golem- Kavajë, duke përmbushur kriterin 2.1 a) të VKM 666, 10.10.2019

2. Efektet financiare do të përballohen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

3. Ngarkohet Qendra Arsimore, Bashkia Pogradec, dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 25.02.2026